

**VENDIM**  
**Nr. 606, datë 29.7.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 4.11.2015, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në kreun II, të vendimit nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
  - a) Në pikën 1, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j”, me këtë përmbajtje:  
“j) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Gjirokastër.”.
  - b) Shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.
2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**